



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

UDHËZIM

Nr. 11....., datë 2.07.2014

PËR
“VENDNDODHJEN DHE KUSHTET E TJERA TË TREGJEVE TË SHITJES ME
SHUMICË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

UDHËZOJ:

- I. Tregjet e produkteve agro-ushqimore me shumicë duhet të plotësojnë këto kritere:
 - a. Të jenë jashtë vijës së verdhë të qyteteve në një distancë jo më të afërt se 500 m nga vija e verdhë;
 - b. Me një distancë jo me pak se 500 m nga zona të miratuara për banim ose pushim;
 - c. Brenda zonave të miratuara për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të produkteve agro-ushqimore me shumicë, të përcaktuara në këtë udhëzim;
 - d. Pranë rrugëve kryesore dhe lehtësisht i aksesueshëm;
 - e. Jo më pak se 1 kilometër larg zonave të kontaminuara ose me ndotje mjedisore, si fabrika që prodhojnë ose gjenerojnë mbetje të dëmshme për shëndetin, mbetje kimike etj.
 - f. Duhet të kenë 2 porta, një hyrëse dhe një dalëse;
 - g. Numri i magazinave brenda stabilimentit të jetë jo më pak se 10 (dhjetë);

- h. Të ketë ambiente frigoriferike;
- i. Të ketë ambiente të vecanta për punonjësit;
- j. Objekti të jetë i rrethuar; të jetë i pajisur 24 orë me ujë dhe energji elektrike.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EDMOND PANARITI

Konceptoi: Luljeta Dervishi
Datë: 02.07.2014
Drejtoresha: Lauresha Grezda
Sek.Përgjith.: Vojo Bregu

